



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

Prishtinë, dt. _____
SL&L. _____

Në pajtim me nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 e dt. 26 nëntor 2004 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji"),

Duke pasur parasysh obligimet që dalin nga Licenca e Shërbimit nr. SL/316 e lëshuar nga ZRRUM për **KRM "UNITETI" Sh.A. Mitrovicë** më 30.11.2005 pika 4.2,

Pas kryerjes së hetimeve dhe ekzaminimit të regjistrave të ZRRUM-it që kanë të bëjnë me evidencën e pagesës së taksës së licencimit nga ofruesit e licencuar të shërbimeve,

Zyra Rregullatore për Ujësjetës dhe Mbeturina (në tekstin e mëtutjeshëm ZRRUM) dërgon këtë:

PARALAJMËRIM

Me të cilin paralajmërohet **KRM "Uniteti" Sh.A.Mitrovicë** se:

- (a) Ka bërë shkelje të detyrimeve nga neni 7.2.a. të Ligjit për faktin se nuk ka paguar taksën e licencimit të pagueshme sipas Nenit 8.2 të po këtij Ligji;
- (b) ZRRUM mund të ndërmerr sanksione ligjore në formë të gjobitjes dhe revokimit të Licencës së Shërbimit në pajtim me Nenin 7.2 dhe Nenit 32 të Ligjit në rast se **KRM "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë** nuk paguan shumën e tërësishme të taksës së licencimit të pagueshme, e cila përfshinë periodën **Mars 2007 - Dhjetor 2007 dhe Mars 2008 – Dhjetor 2008**, gjer më 28 shkurt 2009;
- (c) **KRM "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë** ka mundësi që në afat prej 15 ditë pune ti dërgojë ZRRUM-it një deklaratë me shkrim lidhur me faktet që konsideron se duhen të merren parasysh në mbrojtjen e vet, siç janë faktet që zbusin përgjegjësinë e saj.

ZRRUM do të merr një Vendim lidhur me këtë çështje në pajtim me nenin 7.2 dhe nenit 33.2 të Ligjit Nr. 03/L-086 pas përfundimit të Periudhës së Paralajmërimit.

.....
Afrim Lajçi
Drejtore i ZRRUM

Dërguar;

- Refki Aliu, Drejtore i KRM "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë
- Bajram Rexhepi, Kryetari i Komunës Mitrovicë